



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier, më 27/02/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: objekt “**Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Kamiona, Skrepa, Eskavatorë)**” me 2 lote :

Loti 1: “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Kamiona)”

Loti 2: “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Skrepa, Eskavatorë)”

(Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 muaj)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50110000-9 “Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe pajisjeve të lidhura”.

VLERA E FONDIT LIMIT TË PËRBASHKËT TOTAL : Fondi limit / **vlera e pritshme e përgjithëshme e kontratës: 39 993 983,33** (tridhjetë e nente milion e nenteqind e nentedhjetë e tre mijë e nenteqind e tetëdhjetë e tre presje tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**

Fondi limit/**Vlera e pritshme e kontratës** ne total per LOTIN 1 “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Kamiona)” për 12 muaj është **22 805 166,67** (njetzetë e dy milion e tetëqind e pesë mijë e njeqind e gjashtedhjetë e gjashtë presje gjashtedhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**

Fondi limit/**Vlera e pritshme e kontratës** ne total per LOTIN 2 “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Skrepa, Eskavatorë)” për 12 muaj është **17 188**

816,66 (shtatembedhjete million e njeqind e tetedhjete e tete mije e teteqind e gjashtembedhjete presje gjashtedhjete e gjashte) **lekë pa TVSH**

Objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi të së cilëve është 35 426 616,67** (tridhjete e pese milion e katerqind e njezete e gjashte mije e gjashteqind e gjashtembedhjete presje gjashtedhjete e shtate) **lekë pa TVSH.**

Për **LOTIN 1** shumatorja e çmimeve për njësi është **20 827 350 lekë pa TVSH.**

Për **LOTIN 2** shumatorja e çmimeve për njësi është **14 599 266,67 leke pa TVSH.**

Fondi limit total i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:

1. **Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës** i Bashkisë Fier (per Drejtoria e Shërbimit të M.Z.SH. Fier) është në vlerën 2 239 600 (dy milion e dyqind e tridhjete e nente mije e gjashteqind) leke pa tvsh dhe 2 687 520 (dy milion e gjashteqind e tetedhjete e shtate mije e peseqind e njezete) leke me tvsh.
2. **Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës** i Ndermarrjes së Ujitjes dhe Kullimit Fier është në vlerën 6 341 733,33 (gjashte milion e treqind e dyzete e një mije e shtateqind e tridhjete e tre presje tridhjete e tre) leke pa tvsh dhe 7 610 080 (shtate milion e gjashteqind e dhjete mije e tetedhjete) leke me tvsh.
3. **Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës** i Ndermarrjes së Sherbimeve Rurale Fier është në vlerën 12 620 416,67 (dymbedhjete milion e gjashteqind e njezete mije e katerqind e gjashtembedhjete presje gjashtedhjete e shtate) leke pa tvsh dhe 15 144 500 (pesembdhjete milion e njeqind e dyzete e kater mije e peseqind) leke me tvsh.
4. **Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës** i Ndermarrjes së Sherbimeve Publike Fier është në vlerën 6 357 716,67 (gjashte milion e treqind e pesedhjete e shtate mije e shtateqind e gjashtembedhjete presje gjashtedhjete e shtate) leke pa tvsh dhe 7 629 260 (shtete milion e gjashteqind e njezete e nente mije e dyqind e gjashtedhjete) leke me tvsh.
5. **Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës** i Ndermarrjes së Pastrimit Fier është në vlerën prej 10 345 433,32 (dhjete milion e treqind e dyzete e pese mije e katerqind e tridhjete e tre presje tridhjete e dy) leke pa tvsh dhe 12 414 520 (dymbedhjete milion e katerqind e katermbdhjete mije e peseqind e njezete) leke me tvsh.
6. **Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës** i Ndërmarrjes së Gjellbërimit dhe Mirembajtjes së Varrezave Publike Fier është në vlerën prej 2 089 083,33 (dy milion e tetedhjete e nente mije e tetedhjete e tre presje tridhjete e tre) leke pa tvsh dhe 2 506 900 (dy milion e peseqind e gjashte mije e nenteqind) leke me tvsh .

- LOTI 1: “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Kamiona)”.

Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 1 për 12 muaj eshte **22 805 166,67 lekë pa TVSH**, i shperndare sipas autoriteteve kontraktore:

1. Drejtoria e MZSH Fier (Bashkia Fier) - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 1 për 12 muaj eshte **2 239 600 lekë pa TVSH**.
2. Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit Fier - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 1 për 12 muaj eshte **1 160 666,67 lekë pa TVSH**.
3. Ndërmarrja e Shërbimeve Rurale - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 1 për 12 muaj eshte **6 089 583,33 lekë pa TVSH**.
4. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 1 për 12 muaj eshte **2 250 966,67 lekë pa TVSH**.
5. Ndërmarrja e Pastrimit - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 1 për 12 muaj eshte **9 681 866,67 lekë pa TVSH**.
6. Ndërmarrja e Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 1 për 12 muaj eshte **1 382 483,33 lekë pa TVSH**.

Për LOTIN 1 shumatorja e cmimeve për njësi është 20 827 350 lekë pa TVSH.

- LOTI 2: “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Skrepa, Eskavatorë)”.

Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 2 për 12 muaj eshte **17 188 816,66 lekë pa TVSH**, i shperndare sipas autoriteteve kontraktore:

1. Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit Fier - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 2 për 12 muaj eshte **5 181 066,67 lekë pa TVSH**.
2. Ndërmarrja e Shërbimeve Rurale - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 2 për 12 muaj eshte **6 530 833,33 lekë pa TVSH**.
3. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 2 për 12 muaj eshte **4 106 750 lekë pa TVSH**.
4. Ndërmarrja e Pastrimit - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 2 për 12 muaj eshte **663 566,66 lekë pa TVSH**.
5. Ndërmarrja e Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike - Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës ne total per LOTIN 2 për 12 muaj eshte **706 600 lekë pa TVSH**.

Për LOTIN 2 shumatorja e cmimeve për njësi është 14 599 266,67 lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier (njësia e prokurimit) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1 : “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Kamiona)”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilin është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,

si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Licence, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1, për ushtrimin e veprimtarisë servis automjetesh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe në zbatim të **Udhëzimit të Ministrit të i Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016**, "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove", si dhe ne ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2020, 2021**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel. Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te përcaktuar se: *4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit¹.* Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

legjislacionit të fushës, konkretisht ne ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2020, 2021**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **22 000 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlere jo më e madhe se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet (**per LOTIN 1**)). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: **Pika 1.** *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* **Pika 2/b:** *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal per vleren e xhiros, qe mund te kerkohet ne Proceduren e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore qe u kerkohet operatorëve ekonomike nuk mund te tejkalojë: b) vleren e perlllogaritur te kontrates ose lotit, ne procedurat e prokurimit ndermjet kufirit te larte dhe te ulet monetar*; Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit ndermjet kufirit te larte dhe te ulet monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se eshte e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale te percaktuara ne Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e vertetimit te xhiros vjetore eshte bere bazuar ne nenin 43 te VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kerkon kopje te deklaratave te xhiros vjetore te realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit te xhiros qe mbulon kontrata, per një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*; si dhe nenit 13 te Ligjit nr.8438, date 28.12.1998 ”Per Tatimin Mbi te Ardhurat” i ndryshuar, ku percaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit per deklaratat individuale vjetore e te ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme percaktimin e 2 (dy) viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Per te provuar pervojën e mëparshme, kerkohen dëshmi per furnizimet e mëparshme, te ngjashme, te kryera gjate tre viteve te fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **9 000 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% te vlerës së perlllogaritur te kontrates qe prokurohet (**per LOTIN 1**), qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

- a-** Vertetime te lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasitë e mallrave te furnizuara ose fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shënohen datat, shumat, zerat dhe sasitë e mallrave te furnizuara **ose**
- b-** Ne rastin e pervojës së mëparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruarat ne organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave te furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e furnizimeve të mëparshme të ngjashme prej 40% të fondit të limit/ vlerës së pritshme të kontratës së parashikuar i jep siguri AK që operatorët ekonomikë kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

2.3.2 Operatori/ët Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se **10 (dhjetë) punonjës** për **muajin Janar 2023**. Në këtë numër përfshihet dhe stafi drejtues.

Shënim: Për pikën **2.3.2** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.2**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Janar 2023**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Janar 2023**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore

(pushimet, leje e zakonshme). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Nisur nga natyra e shërbimeve që do të realizohen për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të Bashkisë Fier është gjykuar e arsyeshme që operatori ekonomik të ketë të punësuar minimalisht 10 persona, duke përfshirë stafin drejtues, specialistet që do të kryejnë shërbimin dhe stafin mbështetës.

Vendosja e këtij kriteri është bërë me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqi punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit **Janar 2023** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklaramit dhe të pagesës*), operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur sipas shërbimit konkret që kërkohet dhe punonjësve specialist që nevojiten dhe që janë kërkuar për këtë shërbim.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një Përgjegjës (Drejtues) Teknik të shoqërisë, i cili duhet të jetë i pajisur me:

Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) të veprimtarisë së auto riparimit (*referuar Ligjit Nr.9573, datë 03/07/2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”* të ndryshuar, (Kategoria VII.3.B.1).

Shënim: Për pikën **2.3.3** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.3**, me sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 1/c dhe pikës 4 të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a dhe b, të VKM

nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne se disponojne licensat profesionale qe parashikohen nga legjislacioni ne fuqi per kryerjen e sherbimeve ,objekt I kontrates te leshuara nga autoritetet kompentente; *si dhe operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter bazohet gjithashtu ne Ligjin Nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen , depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtaritë që lidhen me to”.*

2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar

Operatoret ekonomikë pjesmarres duhet te kene te punesuar inxhinierë dhe specialiste te kualifikuar per realizimin me cilesi te sherbimeve te kerkuara, si me poshte:

a)1. Inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti	1 (nje)
b)	
1. Punonjes mekanik	5 (pese)
2. Xhenerik	1 (nje)
3. Motorrist	2 (dy)
4. Elektroauto	1 (nje)
5. Saldator	1 (nje)
6. Pompist	1 (nje)

Operatoret ekonomikë pjesmarres duhe te paraqesin nje listë të punonjësve me profesionet përkatëse që ushtrojnë, përfshirë të gjitha profesionet e kërkuara nga AK më sipër.

a)-Per inxhinierin mekanik ose teknik, mekanik transporti duhet te paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme),
- *Diplome universitare,*

b)-Per specialistet duhet te paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme),
- *Dokument qe te vertetoje kualifikimin sipas profilit te kerkuar (diplome ose certificate profesionale ose deshmi kualifikimi, etj.)*

Shënim: Për pikat **a)** dhe **b)** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a) dhe b)** të pikës **2.3.4**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Ne baze të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin public” dhe nenit 41, pika 4/b dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me ane të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me *zerat, natyrën, volumet e preventivit si dhe me numrin e automjeteve të kerkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.*

2.3.5 Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme/ambjente, për përmbushjen e shërbimeve të kerkuara në përputhje me specifikimet teknike apo termat e referencës të dhëna në DST, si më poshtë:

- a. Vinxh Ure mbi 10 Ton min. 1 (nje) cope,
- b. Vinxh Ure mbi 3 Ton min. 1 (nje) cope,
- c. Pajisje (*kompjuter*) për kontrollin dhe testimin (*diagnostikimin*) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit min. 1 (nje) cope,
- d. Pajisje e testimit për kontrollin fizik në sistemin e drejtimit dhe amortizimit për mjetet e renda (*konvergences se mjeteve*) min. 1 (nje)
- e. Repart motorrik për kontrollin e motorrave me bango-prove, pajisje kontroll injektorësh, sistemit ftohes dhe testate min. 1 (nje)
- f. Repart xhenerik të kompletuar min. 1 (nje)
- g. Repart elektroaut të kompletuar min. 1 (nje)
- h. Repart mekanik- hidraulik me bango-prove min. 1 (nje)
- i. Prese për tubot bokullave dhe rekordeve të diametrave të ndryshëm min 1 (nje)
- j. Torrno min. 2 (dy)
- k. Trapano të ndryshme min. 2 (dy)
- l. Repart saldimi të kompletuar (*saldim elektrik, argon, dhe oksigjen*) min. 1 (nje)
- m. Mjet transportues për transportin e mjeteve të renda deri në servis pa pagesë min.1(nje) (*pronesi ose me qera*)

Shënim: Për pikën **2.3.5 a), b), c), d), e), f), g), h), i), j, k, l, m,** si më sipër, operatorët ekonomikë ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 a), b), c), d), e), f), g), h), i), j, k, l, m,**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Per keto operatori ekonomik duhet te paraqese dokumenta zyrtare qe vertetojne se keto pajisje i ka ne pronesi aktualisht (*dokumenta qe vertetojne blerjen, faturat e blerjes*) **ose** te pasqyruara ne bilancin e shoqerise me zera te vecante **ose** i ka marre me kontrate qeraje te vlefshme. Ne rastin kur jane marre me qira duhet te paraqitet kontrata e qiramarrjes e vlefshme deri ne perfundimin e marreveshjes kuader.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kerkesat per disponimin ose mundësinë e sigurt te disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike te kerkuara ne kete kerkese per kualifikim, bazohet edhe ne nevojen per mundesine e sigurte te disponimit te mjeteve qe AK kerkon nga OE, te cilet duhet te vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si per mjetet qe do te angazhohen ne zbatimin e kontrates, ashtu edhe per kapacitet teknike qe lidhen me gadishmerine per plotesimin e tyre ne rrethana te caktuara, duke pasur si synim zbatimin e ne kohe dhe ne cilesi te kontrates objekt prokurimi.

Vendosja e ketij kriteri eshte bere duke u bazuar edhe ne ligjin nr.9573 date 03.07.2006 “Per autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, te rimorkiove dhe pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit ose te braktisura per veprimtarite qe lidhen me to dhe ne Udhezimin nr.1546 date 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

2.3.6 Operatori ofertues duhet te kete ne pronesi **ose** me qira nje objekt (*servis*) per realizimin e kontrates, te pershtatshem per ushrimin e aktivitetit per realizimin e kontrates, dhe te kete territor te mjaftueshem per parkimin e mjeteve per kohen qe eshte e nevojshme. Ne rastin e ndodhjes se servisit jashte territorit te Bashkise Fier, operatori ekonomik do te marre persiper te kryeje me shpenzimet e veta transportin vajtje – ardhje te automjeteve qe kane nevojte per sherbime.

Shënim: Për pikën **2.3.6** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.6** duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Per keto operatori duhet te paraqese: foto te objektit (*servisit*) ku te pasqyrohen ambjentet e brendshme, repartet, ambjentet e jashtme, etj., si dhe dokumentin e pronesise per servisin

(shoqeruar me hartën treguese hipotekore) ose kontratën noteriale të qirase me afat deri në perfundim të marreveshjes kuader për objektin që prokurimet.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që përpara vlerësimit të ofertave, të verifikojë në vend repartet, mjetet, pajisjet teknike dhe të gjitha ambientet e servisit të sipercituara, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve të kerkuara.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1/c dhe pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”. Vendosja e këtij kriteri është bërë duke u bazuar edhe në ligjin nr.9573 datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtaritë që lidhen me to dhe në Udhezimin nr.1546 datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambientin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambientet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

Vendosja e këtij kriteri është bërë duke u bazuar edhe në ligjin nr.9573 datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtaritë që lidhen me to dhe në Udhezimin nr.1546 datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se të gjitha pjesët e këmbimit objekt prokurimi, (**per LOTIN 1**), që do të përdoren për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, do të jenë origjinale, të reja dhe prodhim sipas standardeve të CE **ose ekuivalente me të**, dhe se operatori ekonomik merr përsipër garancinë e pjesëve të këmbimit për jo më pak se 1 (një) vit, nga data e montimit ose vendosjes, në përputhje me normativat standarde të mirëmbajtjes së automjeteve, bazuar në km të përshkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion Pjesët e

këmbimit të certifikuara sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.
Me anë të kësaj deklarate synohet që pjesët e këmbimit që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi 1 vit garanci.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës garanton se pjesët e këmbimit që do të përdoren për objekt prokurimi (**per LOTIN 1**), do të merren nga kompani prodhuese/distributore të licencuara sipas standartit **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente të saj**.

Shënim: Për piken e mesiperme operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën e mesiperme.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK dhe Certifikatën e menaxhimit **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente të saj të prodhuesit**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 44, pika 1, dhe 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është e cituar: *5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor; dhe në piken 6 të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku është e cituar: *6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.* Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. date 20.03.2018, Rekomandimit nr.7998 prot, date 24.12.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune shërbime” ; dhe Rekomandimit nr. 6732 prot. Date 21.10.2020 si edhe rekomandimeve të Sektorit të Koordinimit për procedura të meparshme të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor; si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që autoriteti kontraktor të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses kontratën.*

Paraqitja e certifikates **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente të saj të prodhuesit (per OE i kualifikuar i pari)** vlerësohet i rëndësishëm dhe i nevojshëm për ekzekutimin me sukses të

kontrates pasi behet e mundur identifikimi i origjines se mallrave objekt prokurimi, dhe garanton per cilesine e pjeseve te kembimit qe do te perdoren per mjetet objekt prokurimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar

LOTI 2 : "Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Skrepa, Eskavatorë)"

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Licence, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1, për ushtrimin e veprimtarisë servis automjetesh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe në zbatim të **Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016**, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, si dhe në ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2020, 2021**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te përcaktuar se: *4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit². Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2020, 2021**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **17 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet (**per LOTIN 2**)). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejmë te përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: **Pika 1.** *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*

² Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;* Duke qene se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me parë gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **6 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (**per LOTIN 2**), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara **ose**
- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohet vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e furnizimeve të mëparshme të ngjashme prej 40% të fondit të limit/ vlerës së pritshme të kontratës së parashikuar i jep siguri AK që operatorët ekonomikë kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

2.3.2 Operatori/ët Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër jo më pak se **10 (dhjetë) punonjës** për **muajin Janar 2023.** Në këtë numër përfshihet dhe stafi drejtues.

Shënim: Për pikën **2.3.2** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.2**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislativës në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Janar 2023.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislativës në fuqi për **muajin Janar 2023.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqerore (pushimet, leje e zakonshme). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Nisur nga natyra e shërbimeve që do të realizohen për mirembajtjen dhe riparimin e mjeteve të Bashkisë Fier është gjykuar e arsyeshme që operatori ekonomik të ketë të punësuar minimalisht 10 persona, duke përfshirë stafin drejtues, specialistet që do të kryejnë shërbimin dhe stafin mbështetës.

Vendosja e këtij kriteri është bërë me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqi punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit **Janar 2023** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqerore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklaramit dhe të pagesës*), operatorët ekonomike kanë afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqerore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur sipas shërbimit konkret që kërkohet dhe punonjësve specialist që nevojiten dhe që janë kërkuar për këtë shërbim.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një Përgjegjës (Drejtues) Teknik të shoqërisë, i cili duhet të jetë i pajisur me:

Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) të veprimtarisë së auto riparimit (*referuar Ligjit Nr.9573, datë 03/07/2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”* të ndryshuar, (Kategoria VII.3.B.1).

Shënim: Për pikën **2.3.3** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.3**, me sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar ne baze të pikës 1/c dhe pikës 4 të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a dhe b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne se disponojne licensat profesionale qe parashikohen nga legjislacioni ne fuqi per kryerjen e sherbimeve ,objekt I kontrates te leshuara nga autoritetet kompentente; *si dhe operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter bazohet gjithashtu ne Ligjin Nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen , depozitim e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura për veprimtaritë që lidhen me to”.*

2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar

Operatoret ekonomikë pjesmarres duhet te kene te punesuar inxhinierë dhe specialiste te kualifikuar per realizimin me cilesi te sherbimeve te kerkuara, si me poshte:

a)1. Inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti	1 (nje)
b)	
1. Punonjes mekanik	5 (pese)
2. Xhenerik	1 (nje)
3. Motorrist	2 (dy)
4. Elektroauto	1 (nje)
5. Saldator	1 (nje)
6. Pompist	1 (nje)

Operatoret ekonomikë pjesmarres duhe te paraqesin nje listë të punonjësve me profesionet përkatëse që ushtrojnë, përfshirë të gjitha profesionet e kërkuara nga AK më sipër.

a)-Per inxhinierin mekanik ose teknik, mekanik transporti duhet te paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme),
- *Diplome universitare,*

b)-Per specialistet duhet te paraqesin bashkëlidhur:

- Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme),
- *Dokument qe te vertetoje kualifikimin sipas profilit te kerkuar (diplome ose certificate profesionale ose deshmi kualifikimi, etj.)*

Shënim: Për pikat **a)** dhe **b)** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a) dhe b)** të pikës **2.3.4**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Ne baze të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin public” dhe nenit 41, pika 4/b dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me ane të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me *zerat, natyrën, volumet e preventivit si dhe me numrin e automjeteve të kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.*

2.3.5 Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për disponueshmerinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme/ambjente, për përmbushjen e shërbimeve të kerkuara në përputhje me specifikimet teknike apo termat e referencës të dhëna në DST, si më poshtë:

- n. Vinxh Ure mbi 10 Ton min. 1 (nje) cope,
- o. Vinxh Ure mbi 3 Ton min. 1 (nje) cope,
- p. Pajisje (*kompjuter*) për kontrollin dhe testimin (*diagnostikimin*) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit min. 1 (nje) cope,
- q. Pajisje e testimit për kontrollin fizik në sistemin e drejtimit dhe amortizimit për mjetet e renda (*konvergjenca të mjeteve*) min. 1 (nje)
- r. Repart motorrik për kontrollin e motorrave me bango-prove, pajisje kontroll injektorësh, sistemit ftohes dhe testate min. 1 (nje)
- s. Repart xhenerik të kompletuar min. 1 (nje)
- t. Repart elektroaut të kompletuar min. 1 (nje)
- u. Repart mekanik- hidraulik me bango-prove min. 1 (nje)
- v. Prese për tubot bokullave dhe rekordeve të diametrave të ndryshëm min 1 (nje)
- w. Torrno min. 2 (dy)
- x. Trapano të ndryshme min. 2 (dy)
- y. Repart saldimit të kompletuar (*saldim elektrik, argon, dhe oksigjen*) min. 1 (nje)
- z. Mjet transportues për transportin e mjeteve të renda deri në servis pa pagesë min.1(nje) (*pronesi ose me qera*)

Shënim: Për pikën **2.3.5 a), b), c), d), e), f), g), h), i), j, k, l, m**, si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 a), b)**,

c), d), e), f), g), h), i), j, k, l, m., duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese dokumenta zyrtare qe vertetojne se keto pajisje i ka ne pronesi aktualisht (*dokumenta qe vertetojne blerjen, faturat e blerjes*) **ose** te pasqyruara ne bilancin e shoqerise me zera te vecante **ose** i ka marre me kontrate qeraje te vlefshme. Ne rastin kur jane marre me qira duhet te paraqitet kontrata e qiramarrjes e vlefshme deri ne perfundimin e marreveshjes kuader.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kerkesat per disponimin ose mundësinë e sigurt te disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike te kerkuara ne kete kerkese per kualifikim, bazohet edhe ne nevojën per mundesine e sigurte te disponimit te mjeteve qe AK kerkon nga OE, te cilet duhet te vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si per mjetet qe do te angazhohen ne zbatimin e kontrates, ashtu edhe per kapacitet teknike qe lidhen me gadishmerine per plotesimin e tyre ne rrethana te caktuara, duke pasur si synim zbatimin e ne kohe dhe ne cilesi te kontrates objekt prokurimi.

Vendosja e ketij kriteri eshte bere duke u bazuar edhe ne ligjin nr.9573 date 03.07.2006 “Per autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, te rimorkiove dhe pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit ose te braktisura per veprimtarite qe lidhen me to dhe ne Udhezimin nr.1546 date 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

2.3.6 Operatori ofertues duhet te kete ne pronesi **ose** me qira nje objekt (*servis*) per realizimin e kontrates, te pershtatshem per ushtrimin e aktivitetit per realizimin e kontrates, dhe te kete territor te mjaftueshem per parkimin e mjeteve per kohen qe eshte e nevojshme. Ne rastin e ndodhjes se servisit jashte territorit te Bashkise Fier, operatori ekonomik do te marre persiper te kryeje me shpenzimet e veta transportin vajtje – ardhje te automjeteve qe kane nevojë per sherbime.

Shënim: Për pikën **2.3.6** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.6** duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Per keto operatori duhet te paraqese: foto te objektit (*servisit*) ku te pasqyrohen ambjentet e brendshme, repartet, ambjentet e jashtme, etj., si dhe dokumentin e pronesise per servisin (*shoqeruar me harten treguese hipotekore*) ose kontraten noteriale te qirase me afat deri ne perfundim te marreveshjes kuader per objektin qe prokurohet.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten qe perpara vleresimit te ofertave, te verifikoje ne vend repartet, mjetet, pajisjet teknike dhe te gjitha ambjentet e servisit te sipercituara, me qellim verifikimin e plotesimit te kushteve te kerkuara.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1/c dhe pikes 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”. Vendosja e këtij kriteri është bere duke u bazuar edhe ne ligjin nr.9573 date 03.07.2006 “Per autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, te rimorkiove dhe pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit ose te braktisura per veprimtarite qe lidhen me to dhe ne Udhezimin nr.1546 date 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet te dërgohen ne ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

Vendosja e këtij kriteri është bere duke u bazuar edhe ne ligjin nr.9573 date 03.07.2006 “Per autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, te rimorkiove dhe pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit ose te braktisura per veprimtarite qe lidhen me to dhe ne Udhezimin nr.1546 date 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklaratë se te gjitha pjesët e këmbimit objekt prokurimi, (**per LOTIN 2**), që do të përdoren për mirembajtjen dhe riparimin e automjeteve, do të jenë origjinale, të reja dhe prodhim sipas standarteve të CE **ose ekuivalente me te** , dhe se operatori ekonomik merr persiper garancinë e pjesëve të këmbimit per jo më pak se 1 (nje) vit, nga data e montimit ose vendosjes, ne perputhje me normativat standarde të mirëmbajtjes së automjeteve, bazuar në km të përshkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion Pjesët e këmbimit të certifikuar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Me anë të kësaj deklarate synohet që pjesët e këmbimit që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi 1 vit garanci.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të se ciles garanton se pjesët e këmbimit që do të perdoren për mjetet objekt prokurimi (**per LOTIN 2**), do të merren nga kompani prodhuese/distributore të licencuara sipas standartit **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente të saj**.

Shënim: Për piken e mesiperme operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën e mesiperme.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK dhe Certifikatën e menaxhimit **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente të saj të prodhuesit**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 44, pika 1 dhe 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku është e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor;* dhe në piken 6 të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku është e cituar: 6. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.* Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. date 20.03.2018, Rekomandimit nr.7998 prot, date 24.12.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune shërbime” ; dhe Rekomandimit nr. 6732 prot. Date 21.10.2020 si edhe rekomandimeve të Sektorit të Koordinimit për procedura të meparshme të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor; si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që

autoriteti kontraktor të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të permbushur me sukses kontraten.

Paraqitja e certifikates **ISO 9001 – 2015 ose ekuivalente te saj te prodhuesit (per OE i kualifikuar i pari)** vleresohet i rendesishem dhe i nevojshem per ekzekutimin me sukses te kontrates pasi behet e mundur identifikimi i origjines se mallrave objekt prokurimi, dhe garanton per cilesine e pjeseve te kembimit qe do te perdoren per mjetet objekt prokurimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te ndryshuar

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga Grupi i Punes i ngritur me Urdher te Titullarit te Autorizuar me Nr.7401 Prot date 08.09.2022 me lende “Mbi ngritjen e grupit te Punes per identifikimin e nevojës, hartimin e termave te references se sherbimit dhe specifikimeve teknike, si dhe hartimin e kerkesave te vecanta per kualifikim qe lidhen me kapacitetin teknik per zhvillimin e procedures se prokurimit publik me objekt: “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Kamiona, Skrepa, Eskavatorë)” i cili ka përgatitur listën me zëra të shërbimeve të kërkuara për mjetet e rënda , si dhe ka hartuar dhe argumentuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 41, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Gjithashtu Grupi i Punes , i ngritur me Urdher te Titullarit te Autorizuar me Nr.1526 Prot date 17.02.2023, me lende “Per ngritjen e komisionit te testimi te tregut dhe perllogaritjen e fondit limit” “Shërbim për mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve të rënda të Bashkisë Fier (Kamiona, Skrepa, Eskavatorë)”, ka pergatitur dokumentacionin e studimit te tregut dhe perllogaritjen e fondit limit.

Kriteret e vecanta te kualifikimit qe lidhen me kapacitetin teknik jane hartuar nga specialistet e fushes pjese e njesise se prokurimit, ne baze te materialit te ardhur me me nr 7401/3 prot date 02/12/2023

Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes pjese e njesise se prokurimit.

Njësia e prokurimit: